

Informata të rëndësishme për vizitorët e

Stacionit të kujdesit intensiv ndërdisiplinar Stacionit të mbikëqyrjes



Të dashur familjarë, të dashur vizitorë,
keni ardhur në Spitalin Kantonal Solothurn, sepse dëshironi të vizitoni një paciente ose një pacient në stacionin e kujdesit intensiv ndërdisiplinar. Për këtë jemi shumë të gëzuar, sepse me vizitën tuaj, ju e jepni një kontribut të çmueshëm për mirëqënien e personit tuaj të afërt.

Kujdesja

Stacioni i kujdesit intensiv dhe ai i mbikëqyrjes i shërbejnë trajtimit dhe mbikëqyrjes intensive, mjekësore të njerëzve të sëmurë rëndë. Mbikëqyrja dhe trajtimi i pacientëve zhvillohet si gjatë ditës, ashtu edhe gjatë natës – pa ndërprerje!

Pacientët me frymëmarrje artificiale dhe të alivanosur

Pacientet dhe pacientët, të cilët furnizohen me frymëmarrje artificiale, nuk janë në gjendje për të folur, por mund të dëgjojnë dhe të ndjejnë. Gjithashtu edhe pacientët e alivanosur (pa vetëdije) mund të perceptojnë ndikimet nga ambienti i tyre. Për këtë arsye, është shumë e arsyeshme, dhe e dëshiruar, që ju të flisni me pacientin si dhe ta prekni atë.

Personat e kontaktit

Për shkak të detyrimit për ruajtjen e të fshehtave, ne mund t'ju informojnë vetëm të afërmit më të ngushtë mbi gjendjen e pacientit. Duke u bazuar në këtë, do t'ju ishim shumë mirënjohës, nëse do të caktonit një deri dy persona në kuadër të rrethit tuaj familjar, të cilët do të jenë në kontakt të vazhdueshëm me ne.

Mbrojtja e të dhënave

Detyrimi për ruajtjen e të fshehtave: mund të ndodhë që gjatë një vizite të kuptoni për gjëra konfidenciale mbi pacientët e tjerë.

Ju lutemi të keni parasysh, që si të gjithë bashkëpunëtorët tanë, edhe ju i nënshtrohni detyrimeve për ruajtjen e të fshehtave. Edhe ju do ta vlerësoni, nëse ju ruhet sfera juaj e privatësisë.

Kamerat: të gjithë dhomat e stacionit të kujdesit intensiv janë të pajisura me kamera të mbikëqyrjes, në mënyrë që të jetë e garantuar siguria e pacientëve tanë. Të dhënat nuk memorizohen.

Orari i vizitave

Për arsye mjekësore si dhe për shkak të hapësirës së kufizuar, vetëm maksimalisht 2 vizitorëve njëkohësisht ju lejohet qëndrimi pranë krevatit të pacientit. Ne qëllimisht nuk kemi caktuar ndonjë orar fiks për vizita, sepse zhvillimi ditor nuk është i planifikueshëm. Për këtë arsye mund të rezultojnë edhe kohërat e pritjes. Sipas përvojës tonë, ka rezultuar si më e përshtatshme, nëse bëhen vizita më të shpeshta, por me kohëzgjatje më të shkurtër. Lutemi që të mos sillni lule. Për arsye higjienike lulet janë të ndaluara në stacionin i kujdesit intensiv.

Fëmijët

Për fëmijët e shkollës nën 12 vjeç, qëndrimi si vizitorë në stacionin e kujdesit intensiv vetëm atëherë lejohet, nëse gjindet i shtruar si pacient në stacionin e kujdesit intensiv prindi, një person me afërsi të ngushtë familjare ose një person tjetër me afërsi shumë të ngushtë për fëmijën. Lutemi që në të tilla raste të konsultoheni paraprakisht me personelin e infermierisë.

Keni pyetje?

Për pyetjet tuaja jemi në dispozicionin tuaj në çdo kohë! Në qoftë se dëshironi një bisedë të zgjedhshme me një mjekë, me një mjek, me shumë kënaqësi do t'ju organizojmë një termin.

Stacioni i kujdesit intensiv

Për informata telefonike kontaktoni ju lutem këtë numër 062 311 42 82

Mund të na kontaktoni në çdo orë. Luteni të keni mirëkuptim, nëse informatat mbi gjendjen e një pacienteje, e një pacienti, mund t'j japim vetëm të afërmëve më të ngushtë.

Vendparkimet

Në hapësirën e spitalit mund të gjeni vendparkime me pagesë. Në rast të vizitave më të shpeshta apo që zgjasin më shumë, keni mundësinë të nxirrni një kartë ditore apo javore. Për këtë merreni me vete biletën tuaj nga godina e parkimit dhe vazhdojeni tek sporteli i informacionit pranë hyrjes kryesore.

Orari i punës i restorantit

E hënë – e premte ora 6.45 deri ora 19.00 Uhr

E shtunë – e dielora 8.00 deri ora 18.00 Uhr



Kantonsspital Olten
Baslerstrasse 150, 4600 Olten
Telefon 062 311 41 11, Telefax 062 311 54 69
info.kso@spital.so.ch, www.so-H.ch